

# Raporti i vitit 2018 për Liritë Fetare Ndërkombëtare, pjesa për Kosovën

## Përmbledhje ekzekutive

Kushtetuta ndalon diskriminimin fetar dhe parashikon liri fetare që u nënshtrohen kufizimeve për të siguruar rend publik, shëndet dhe siguri ose për t'i mbrojtur të drejtat e të tjerëve. Ligji nuk i lejon grupet fetare të regjistrohen si subjekte ligjore, duke krijuar kështu pengesa për ta në përmbushjen e detyrave të veta. Në vitin 2017, Parlamenti votoi për shqyrtimin e një projektligji që do ta lejonte regjistrimin e grupeve fetare si subjekte ligjore në mënyrë që ato të mund t'i kryenin punët dhe çështjet ligjore me subjektet shtetërore e private, por ligji nuk ishte miratuar deri në fund të vitit. Më 23 mars, një panel i Gjykatës Themelore në Prishtinë e liroi Shefqet Krasniqin nga aktakuza e shkurtit të vitit 2017, e ngritur nga Prokuroria Speciale e Kosovës (PSRK) për nxitje të terrorizmit e të urrejtjes fetare, dhe për evazion fiskal. Ndonëse grupet fetare thanë që në përgjithësi kishin marrëdhënie bashkëpunimi me qeverinë lokale, disa grupe thanë që qeveritë komunale nuk i trajtonin njëllëj organizatat fetare në çështje të pronës, përfshirë lejet për ndërtim. Përfaqësueses të Kishës Ortodokse Serbe (KOS) thanë që qeveria shkeli të drejtat pronësore të KOS-it, përfshirë refuzimin për t'i zbatuar vendimet gjyqësore në favor të KOS-it ose vazhdimin e ndërtimeve në zonat e veçanta të mbrojtura (ZVM). Autoritetet e Deçanit, përfshirë kryetarin e komunës, vazhduan ta refuzojnë zbatimin e një vendimi të Gjykatës Kushtetuese të vitit 2016, me të cilin 24 hektarë tokë të kontestuar rreth Manastirit të Deçanit i jepeshin KOS-it; autoritetet qeveritare nuk mbajtën përgjegjës asnjë nëpunës komunal. Komuna, me mbështetje nga qeveria qendrore, filloi ndërtimin e një rruge përmes ZVM-së rreth Manastirit të Deçanit, në kundërshtim me ligjin e Kosovës për ndalimin e ndërtimeve në ZVM. Bashkësia Islame e Kosovës (BIK) vazhdoi të raportonte për diskriminim social dhe në punësim kundër myslimanëve të devotshëm, posaçërisht në sektorin publik. Qeveria vazhdoi të punonte me BIK-un për ta luftuar ekstremizmin e dhunshëm dhe e dënoi vandalizimin e vendeve fetare.

Sipas raporteve policore, protestuesit sulmuan pelegrinët ortodoksë serbë dhe penguan mbajtjen e shërbesave kishtarë në Gjakovë e Istog. Grupet fetare rregullisht takoheshin me njëri-tjetrin për t'i diskutuar të drejtat pronësore, prioritetet legjislativë dhe çështjet e komunitetit lokal. Udhëheqës fetarë morën pjesë në një sërë diskutimesh ndërfaqetare për të drejtat pronësore, prioritetet legjislativë dhe çështjet e komunitetit lokal. Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) vazhdoi t'i koordinonte disa aktivitete ndër grupe fetare, përfshirë takimet me kryetarë të komunave, për t'i diskutuar çështjet si lejet për ndërtimin e objekteve fetare. Më 6 janar dhe 28 gusht, shqiptarët organizuan protesta kundër pelegrinazheve të planifikuara para Kishës Ortodokse Serbe në Gjakovë. Protestuesit shqiptarë në Istog e gjetiu sulmuan ose frikësuan pelegrinët ortodoksë serbë në shumë raste. Më 21 tetor, mediat raportuan që shqiptarët gjuajtën me gurë dy autobusë që transportonin pelegrinë serbë për shërbesat fetare afër Istogut. Policia arrestoi pesë shqiptarë për prishje të rendit publik dhe tre të mitur shqiptarë për dëmtim të autobusëve. Një prokuror i liroi më vonë të dyshuarit në pritje të vendimit për të mos ngritur akuza. Prokurori nuk ofroi asnjë sqarim për këtë vendim. Policia filloi procedurën disiplinore kundër policëve përgjegjës për siguri për shërbesa fetare, duke suspenduar një toger për 48 orë.

Ambasadori dhe përfaqësues të tjerë të Ambasadës së SHBA-së shpesh u takuan me zyrtarë qeveritarë për ta nxitur tolerancën fetare dhe për t'i dënuar publikisht incidentet e dhunës ose rastet e frikësimit. Ambasadori dhe përfaqësues të Ambasadës së SHBA-së gjithashtu ushtruan trysni për miratimin e legjislationit për t'u lejuar institucioneve fetare që të fitonin status ligjor dhe për zbatimin e plotë të Kushtetutës dhe ligjit për mbrojtjen e objekteve

fetare. Ambasada e mbrojti rregullisht në të gjitha nivelet e qeverisë zbatimin e plotë të vendimeve gjyqësore në dobi të bashkësive fetare të pakicave dhe inkurajonte zgjidhjen e mosmarrëveshjeve pronësore ku përfshiheshin grupet fetare. Ambasadori dhe përfaqësues të tjerë të Ambasadës ushtruan tryzni në nivelet më të larta qeveritare për t'i ndjekur penalisht autorët e dhunës ose frikësimit kundër KOS-it, dhe për t'i respektuar të drejtat pronësore të KOS-it. Ambasada dekurajonte zyrtarët publikë, institucionet arsimore dhe subjektet e tjera nga angazhimi në praktika diskriminuese të punësimit ndaj myslimanëve të devotshëm ose grupeve të tjera fetare. Zyrtarët e Ambasadës rregullisht diskutuan tolerancën fetare me udhëheqësit e të gjitha bashkësive të mëdha fetare.

## **Seksioni I. Demografia fetare**

Qeveria e SHBA-së vlerëson se numri i përgjithshëm i popullsisë është 1,9 milionë banorë (vlerësim i korrikut të vitit 2018). Të dhënat e regjistrimit nga viti 2011 tregojnë se 95,6 për qind e popullsisë identifikohen si myslimanë, 2,2 për qind si katolikë romanë dhe 1,4 për qind si serbë ortodoksë. Kategoritë e regjistrimit për “Tjetër”, “Asnjë”, ose “S’ka përgjigje” përbëjnë secila më pak se 1 për qind. Sipas KOS-it dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, bojkotimi i regjistrimit nga ana e serbëve rezultoi në llogaritje shumë më të ulët të anëtarëve të KOS-it. Bashkësitë e tjera fetare, përfshirë tarikatet dhe protestantët, gjithashtu i kontestojnë të dhënat e regjistrimit të përgjithshëm. Udhëheqësit protestantë dhe ata pa përkatësi fetare thanë se padrejtësisht disa anëtarë të bashkësive të tyre ishin klasifikuar gabimisht si myslimanë nga personat që bënë regjistrimin e përgjithshëm. Sipas rregullores për regjistrim të përgjithshëm, zyrtarët e regjistrimit nuk i pyetnin qytetarët nëse ishin protestantë.

Pjesa më e madhe e popullatës myslimane i takon shkollës Hanafi Suni, ndonëse disa janë pjesë e komunitetit Sufi Tarikat. Ka edhe komunitet Bektashi Sufi, që përbëhet nga një numër i vogël i anëtarëve. Udhëheqësit e tarikateve theksojnë se bektashianët janë njëri prej nëntë urdhrave të tarikatit, por bektashianët e identifikojnë veten si urdhër i veçantë islamik.

Shumica e anëtarëve të KOS-it jetojnë në dhjetë komunat me shumicë serbe. Bashkësitë më të mëdha katolike janë në Gjakovë, Janjevë, Klinë, Prishtinë dhe Prizren. Popullatat protestante ungjillore gjenden në tërë vendin dhe janë të përqendruara në Prishtinë dhe Gjakovë. Një numër i vogël i hebrenjve jeton në Prizren dhe Prishtinë.

Feja dhe përkatësia etnike janë shpesh të lidhura. Pjesa më e madhe e shqiptarëve janë myslimanë, ndërsa disa janë katolikë dhe protestantë; pothuaj të gjithë serbët i përkasin KOS-it. Pjesa më e madhe e ashkalinjve, boshnjakëve, egjiptianëve, goranëve, romëve dhe turqve gjithashtu janë myslimanë, ndërsa pjesa më e madhe e malazezëve dhe disa romë i përkasin KOS-it. Pothuaj të gjithë kroatët i përkasin kishës katolike.

## **Seksioni II. Statusi i respektimit të lirisë fetare nga Qeveria**

### **KORNIZA LIGJORE**

Kushtetuta parashikon të drejtën e lirisë së ndërgjegjes dhe fesë për të gjithë qytetarët, përfshirë të drejtën për ta ndërruar, shprehur apo për të mos e shprehur besimin fetar, për ta ushtruar fenë apo për të mos e ushtruar fenë, dhe për t’iu bashkuar apo refuzuar për t’iu bashkuar një bashkësie fetare. Këto të drejta u nënshtrohen kufizimeve për shkak të sigurisë dhe rendit publik ose për ta mbrojtur shëndetin apo të drejtat e të tjerëve. Kushtetuta parashikon ndarjen e bashkësive fetare nga institucionet publike, përfshirë të drejtën e

grupeve fetare për t'i rregulluar në mënyrë të pavarur organizimet, aktivitetet dhe ceremonitë e tyre, dhe të drejtën për të themeluar shkolla fetare dhe institucione bamirësie. Ajo garanton të drejta të barabarta për të gjitha bashkësitë fetare, përcakton që vendi është shtet laik dhe neutral lidhur me fenë, deklaron që shteti do ta sigurojë mbrojtjen dhe ruajtjen e trashëgimisë fetare të vendit dhe ndalon diskriminimin e bazuar në fe. Kushtetuta përcakton që ligji mund ta kufizojë lirinë e shprehjes për ta parandaluar provokimin e dhunës dhe armiqësisë për shkak të racës, nacionalitetit, përkatësisë etnike apo fesë. Ajo u lejon gjykatave t'i ndalojnë organizimet apo aktivitetet që inkurajojnë urrejtje racore, nacionale, etnike apo fetare.

Kushtetuta përcakton që bashkësitë tradicionalisht të pranishme në vend, përfshirë bashkësitë fetare, kanë të drejta specifike, përfshirë mbajtjen, zhvillimin dhe ruajtjen e fesë e tyre, përdorimin e gjuhës së tyre, themelimin dhe menaxhimin e shkollave të tyre private me ndihmë financiare nga shteti, dhe qasje në mediat publike. Në të drejta shtesë përfshihen themelimi dhe përdorimi i mediave të veta, mbajtja e kontakteve të papenguara e paqësore me persona jashtë vendit me të cilët ndajnë identitet fetar dhe qasje të barabartë në punësim publik. Kushtetuta ua garanton bashkësive pakicë 20 prej 120 ulëseve në kuvendin nacional. Ajo gjithashtu përcakton që miratimi, ndryshimi ose shfuqizimi i cilitdo ligj që ka të bëjë me lirinë fetare dhe trashëgiminë kulturore kërkon miratim nga shumica e deputetëve që i përfaqësojnë bashkësitë pakicë, si dhe nga shumica e të gjithë deputetëve.

Kushtetuta parashikon Institucionin e Avokatit të Popullit, i cili është përgjegjës për monitorimin e lirisë fetare, ndër të drejta të tjera të njeriut, dhe për rekomandim të veprimeve për t'i korrigjuar shkeljet. Kushtetuta përcakton që shteti do t'i ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për t'i mbrojtur individët që mund të jenë subjekt i kërcënimit, armiqësisë, diskriminimit apo dhunës për shkak të identitetit të tyre fetar.

Ligji nuk kërkon që grupet të regjistrohen dhe nuk parashikon mekanizëm ligjor apo udhëzim specifik që grupet fetare të fitojnë status ligjor përmes regjistrimit apo mënyrave të tjera. Pa status ligjor, grupet fetare nuk mund të posedojnë pronë, të hapin llogari bankare, të punësojnë personel, të kenë qasje në gjykata apo të kryejnë punë të tjera administrative në emër të tyre. Komunitetet lokale shpesh njohin posedimin e ndërtesave nga grupet fetare; megjithatë, ligji nuk i mbron këto ndërtesa. Prona e KOS-it bën përjashtim. Ligji për ZVM-në dhe Ligji për pavarësinë e mbikëqyrur njohin pronësinë e KOS-it për pronat dhe ia caktojnë kujdestarinë për zona të caktuara.

Ligji përcakton që nuk ka fe zyrtare, por i cek pesë bashkësi "tradicionale" fetare: myslimane, ortodokse serbe, katolike, hebraike (çifute) dhe evangjeliste protestante. Ligji parashikon mbrojtje dhe përfitime shtesë për këto pesë grupe, përfshirë taksat e reduktuara.

Ligji parashikon mbrojtje për ZVM-të fetare e kulturore në bazë të rëndësisë fetare e kulturore duke i ndaluar ose kufizuar aktivitetet në afërsi që mund ta dëmtojnë mjedisin e tyre historik, kulturor apo natyror. Sipas ligjit, Këshilli për Zbatim dhe Monitorim (KZM) gjykon kontestet mes Qeverisë dhe KOS-it lidhur me ZVM-të dhe çështje të tjera që kanë të bëjnë me mbrojtjen e trashëgimisë fetare e kulturore të KOS-it. KZM-ja është organ i posaçëm që rrjedh nga Propozimi Gjithëpërfshirës i vitit 2007 për zgjidhjen e statusit të Kosovës (i njohur si Plani i Ahtisaarit) dhe Ligji për ZVM-të. Në anëtarë të KZM-së përfshihen Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) (si bashkëkryesuese), Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, KOS-i, Përfaqësuesi Special i Bashkimit Evropian (si bashkëkryesues) dhe OSBE-ja.

Komunat janë ligjërisht përgjegjëse për mirëmbajtjen dhe meremetimin e të gjitha varrezave publike, përfshirë ato të caktuar për bashkësive specifike fetare.

Sipas ligjit, “institucionet e arsimit publik duhet të përmbahen nga mësimdhënia fetare ose aktivitetet e tjera që përfshijn fe specifike”. Ky ligj nuk zbatohet në shkollat që veprojnë nën strukturat paralele të udhëhequra nga Qeveria e Serbisë, mbi të cilat Qeveria e Kosovës nuk ka kontroll.

Vendi nuk është palë e Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike.

## **PRAKTIKAT QEVERTARE**

Më 23 mars, një panel i Gjykatës Themelore në Prishtinë e liroi Shefqet Krasniqin, ish-krye imam i Xhamisë së Madhe në Prishtinë, nga aktakuza e shkurtit të vitit 2017, e ngritur nga Prokuroria Speciale e Kosovës (PSRK) për nxitje të urrejtjes fetare dhe evazion fiskal. Kryetari i trupit gjykues citoi deklaratat kundërtëdhënëse dhe mungesë të provave si arsye për lirimin e tij. Më 1 tetor, Gjykata e Apelit e mbështeti vendimin e gjykatës së shkallës së ulët, me të cilin Krasniqi lirohej nga të gjitha akuzat.

Më 18 maj, Gjykata e Apelit në Prishtinë i liroi katër imamë, të cilët Gjykata Themelore në Prishtinë i kishte akuzuar në vitin 2017 për kryerje të veprave terroriste ose “nxitje të urrejtjes nacionale, racore, fetare e etnike”, duke cituar mungesën e provave.

Udhëheqësit fetarë vazhduan ta përkrahnin miratimin e një projektligji në vitin 2015 që do të siguronte një mekanizëm përmes të cilit grupet fetare do të mund të fitonin status ligjor. Ky projektligj kaloi në leximin e parë në Kuvend në vitin 2017, por një sërë mosmarrëveshesh politike, që nuk kishin të bënin me këtë ligj, vazhduan ta vononin miratimin e tij përfundimtar. Ky ligj do t’u mundësonte grupeve fetare të kryenin punë dhe çështje ligjore me subjektet shtetërore e private. Bashkësia Bektashi gjithashtu kërkoi që ligji të cekte se ajo është një bashkësi e veçantë islame, pjesë përbërëse e trashëgimisë historike dhe e jetës kulturore dhe sociale në vend. Ndonëse përfaqësuesit e shumë grupeve fetare thanë se kishin gjetur mënyra alternative për të kryer punët e tyre, shumica prej tyre raportuan për vështirësi në regjistrimin e pronës dhe të automjeteve, në hapjen e llogarive bankare dhe në pagimin e tatimit për të ardhurat e punëtorëve. Të gjitha bashkësitë fetare thanë se vazhduan të operonin me llogari bankare që nuk ishin në emër të bashkësisë së tyre dhe Kisha Protestante Ungjillore e Kosovës (KPUK) tha se vazhdonte të tatohej si biznes fitimprurës.

Sipas BIK-ut, disa zyrtarë të shkollave vazhduan ta zbatonin një udhëzim administrativ (rregullor) të detyrueshëm, të lëshuar më herët nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, që ua ndalon nxënësve të shkollave fillore e të mesme veshjen e rrobave fetare në pronën e shkollës. Sipas BIK-ut dhe udhëheqësve të bashkësive të tjera myslimane, shkollat publike nganjëherë i dërgonin në shtëpi nxënëset që ngulnin këmbë në veshjen e shamisë gjersa e vijonin mësimin; megjithatë, gjatë këtij viti, Institucioni i Avokatit të Popullit nuk pranoi asnjë raport që shkollat ua kishin ndaluar vijimin e mësimin nxënësve që vishnin rroba fetare, si shamitë. Mediat raportuan që një profesor në Universitetin e Prishtinës i kishte kërcënuar disa studente që mbanin shami, dhe i kishte detyruar të largoheshin nga ora mësimore. Studentet ia raportuan këto raste Këshillit Etik të Universitetit, i cili nuk ishte takuar deri në fund të vitit për ta diskutuar këtë çështje.

Grupet fetare thanë që qeveritë komunale nuk i trajtonin njëllorj organizatat fetare në çështje pronësore. Ndonëse ligji përcakton që komunat janë përgjegjëse për mirëmbajtjen e varrezave, në praktikë, disa komuna u lejonin grupeve fetare të merrnin posedim *de facto* të varrezave publike. Sipas BIK-ut dhe KPUK-ut, autoritetet nganjëherë lejonin ose i detyronin imamët lokalë të BIK-ut t'i mbikëqyrnin operacionet ditore në varreza. Ndonëse grupet fetare jomyslimane raportuan në përgjithësi për marrëdhënie të mira me imamët në varreza anembanë vendit, përfaqësues të KPUK-ut thanë se imamët lokalë dhe autoritete të tjera të BIK-ut nganjëherë i ngarkonin për shërbime, madje edhe kur i siguronin meshtarët e vet. Bashkësitë katolike dhe ortodokse të Prishtinës vazhduan të përdornin varreza të veçanta publike.

Më 18 dhe 19 qershor, si pjesë e një ndodhie vjetore, përfaqësues të bashkësisë hebraike dhe një kompani lokale për shërbime publike pastruan dhe meremetuan varrezat hebraike në Prishtinë. Anëtarë të bashkësisë hebraike thanë se u mungonin resurset për t'i mirëmbajtur varrezat e veta dhe autoritetet lokale nuk i mirëmbanin këto vende publike siç kërkohet me ligj. Sipas përfaqësuesve të bashkësisë hebraike, qeveritë lokale nuk i mirëmbanin varrezat hebraike në Novobërdë, Lipjan, Kamenicë, Prizren, Mitrovicë dhe Gjilan.

KOS-i dhe organizatat ndërkombëtare thanë që zyrtarët komunalë të Deçanit vazhduan të refuzonin ta zbatonin një vendim të Gjykatës Kushtetuese të vitit 2016 me të cilin konfirmohej aktvendimi i Gjykatës Supreme, i vitit 2012, që komuna duhet t'ia kthejë më tepër se 24 hektarë tokë Manastirit të Deçanit të KOS-it. Kryetari i komunës, Bashkim Ramosaj, vazhdoi gjatë tërë vitit ta quante vendimin të papranueshëm. Autoritetet qeveritare nuk e mbajtën përgjegjës atë apo zyrtarë të tjerë komunalë për moszbatim të vendimit të Gjykatës Kushtetuese. Ushtarët e Forcës së NATO-s për Kosovën, e njohur si KFOR, vazhduan të ofronin siguri në manastir.

Komuna e Deçanit vazhdoi tutje me planet për ndërtim të një rruge përmes ZVM-së afër Manastirit të Deçanit. Sipas opinionëve ligjore të BE-së dhe OSBE-së, të lëshuara gjatë vitit, ligji i Kosovës ndalon ndërtimin e një rruge transit përmes ZVM-së. Zyra e Kryeministrit nuk u pajtua me këtë interpretim ligjor. Në vitin 2004, KZM vendosi që rruga e planifikuar do ta shkelte ligjin. KZM ripohoi paligjshmërinë e kësaj rruge në një takim të mbajtur në prill.

Udhëheqja e BIK-ut raportoi se grupi vazhdoi ta mbështeste, por pa sukses, ndërtimin e një xhamie në Mitrovicën veriore, të cilën forcat e Republikës Federale të Jugosllavisë e shkatërruan në vitin 1999.

Puna përgatitore filloi gjatë vitit për ta lidhur vendin për ndërtimin e një "xhamie të madhe" të re në Prishtinë në rrjetin e kompanisë publike për furnizim me ujë. Ndërtimi duhej të fillonte në vitin 2019, por pret miratimin nga komuna.

Deri në fund të vitit, komuna e Prishtinës nuk e kishte ndarë një ngastër toke, të miratuar me një vendim komunal në vitin 2016, për ndërtimin e një sinagoge për bashkësinë hebraike. Udhëheqësit e bashkësisë hebraike thanë që kjo ishte për shkak të vonësve administrative dhe pritej që komuna ta ndante ngastrën në vitin 2019. Bashkësia hebraike në Prizren mori në vitin 2016 miratimin nga komuna e Prizrenit për rinovimin e një ndërtese për t'u përdorur si muze dhe qendër kulturore. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit i dha 5.000 euro (5.700 dollarë amerikanë) për këtë projekt gjatë vitit të kaluar. Bashkësia hebraike priste që ndërtimi të fillojë në vitin 2019.

Sipas KOS-it dhe organizatave ndërkombëtare, nuk pati përparim gjatë vitit për zgjidhjen e mohimit të vitit 2016 nga ana e Qeverisë të lejes për ndërtim të kërkuar nga KOS-i për rindërtimin e kishës së Shën Nikollës në Manastirin e Shën Arkangjelit në Prizren. Në mohimin e lejes, Ministria e Kulturës theksoi se KOS-i nuk ishte i regjistruar si pronar legjitim i tokës në regjistrat qeveritarë. KOS-i tha se pasi qeveria kishte mohuar lejen pas mbarimit të afatit ligjor, leja ishte lëshuar automatikisht. KOS-i tha se qeveria po e shkelte ligjin dhe Planin e Ahtisaarit, i cili i jep diskrecion të plotë KOS-it për të menaxhuar me objektet e veta historike. Si përgjigje ndaj brengave të Ministrisë së Kulturës, një ekspert i financuar nga OSBE-ja ekzaminoi vendin për të përcaktuar nëse një objekt para-ekzistues arkeologjik ishte i pranishëm, megjithatë, ai nuk i kishte publikuar gjetjet deri në fund të vitit.

Ankesa e komunës së Prishtinës kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore për pronën e zotëruar nga Kisha Katolike afër Katedrales së Nënës Terezë mbeti e pazgjidhur në fund të vitit. Më 26 shkurt, Gjykata e Apelit vendosi në favor të pronësisë së Kishës Katolike për më shumë se 7.500 metra katrore tokë, duke hedhur poshtë kërkesën e komunës së Prishtinës për tokë.

Njësia shumetnike policore për mbrojtje të specializuar të objekteve të trashëgimisë kulturore e fetare, e udhëhequr nga një komandant serb i policisë së Kosovës, vazhdoi të ofronte siguri 24-orëshe në 24 ZVM anembanë vendit. Për herë të parë, që nga pavarësia e vendit më 2008, nuk pati incidente gjatë këtij viti në këto objekte. Sipas raporteve policore dhe KOS-it, vjedhja dhe vandalizmi vazhduan në objektet e KOS-it jashtë ZVM-ve në vendet ku policia nuk ofronte mbrojtje të veçantë. Ministria e Kulturës tha se kishte kërkuar mbështetje shtesë nga qeveritë lokale për mbrojtjen e objekteve të trashëgimisë kulturore.

Sipas KPUK-ut, Dogana e Kosovës vazhdoi të kërkonte që KPUK-u ta paguante një gjobë të vënë në fund të vitit 2017 për keqpërdorim të importeve pa doganë për organizata fetare, duke theksuar se shitja e KPUK-ut për fitim e veshmbathjeve të përdorura të importuara shkelte Kodin Doganor. Një opinion ligjor i OSBE-së vuri në pah kundërthëniet në ligjin e Kosovës lidhur me shitjen e mallrave për qëllime bamirësie. KPUK raportoi për shitje të suksesshme të një dërgesë të mallrave në gusht pa paguar doganën, ndonëse interpretimi ligjor mbeti i paqartë në fund të vitit.

Sipas zyrtarëve komunalë dhe OJQ-ve, qeveria qendrore vazhdoi të siguronte pak financim për edukatën islame në medresetë e BIK-ut në Prishtinë, Prizren dhe Gjilan. Disa anëtarë të grupeve të tjera fetare dhe përfaqësues jofetarë thanë që ky financim ishte diskriminues, sepse qeveria nuk siguronte financim për edukatën fetare për asnjë grup tjetër fetar.

Sipas Ministrisë së Arsimit, serbët, goranët, kroatët dhe disa romë vazhduan ta vijonin mësimin në gjuhën serbe në shkollat publike që vepronin në kuadër të strukturave paralele të qeverisë serbe mbi të cilat Qeveria e Kosovës nuk kishte kontroll. Shumica e serbëve zgjidhnin të regjistroheshin në orë të edukatës fetare ortodokse serbe në vend të edukatës qytetare. Qeveria e Serbisë i financonte pagat e të gjithë mësimdhënësve në shkollat në gjuhën serbe, përfshirë instruktorët fetarë. Qeveria e Kosovës i plotësoi pagat e disa mësimdhënësve dhe të stafit në shkollat në gjuhën serbe.

BIK-u vazhdoi të raportonte për diskriminim social dhe në punësim kundër myslimanëve të devotshëm, posaçërisht në sektorin publik.

Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit (ARRU) vazhdoi t'i lironte nga pagesa e shërbimeve për ujë ndërtesat fetare që u përkasin pesë bashkësive fetare "tradicionale", në pajtim me ligjin. Komisioni për Bujqësi tha se filloi fazat e hershme të shqyrtimit të projektligjit për rregullimin e shërbimeve të ujit në tetor, duke theksuar se ligji i vitit 2006 për lirinë fetare nuk parashihte përjashtim. Bazuar në projekt-amendamentet e propozuara, nga të gjitha bashkësitë fetare do të kërkohet t'i paguajnë taksat e shërbimeve të ujit. Udhëheqësit fetarë thanë se u kundërviheshin amendamenteve të propozuara, por ARRU tha se ishte e nevojshme për ta parandaluar keqpërdorimin e mundshëm të shërbimeve. Në fund të vitit, lirim i nga pagesa për shërbime të ujit vazhdoi.

Ministria e Punëve të Jashtme ndaloi mbajtjen e Konferencës Ndërkombëtare Ndërfetare pas largimit në vitin 2017 të zyrtarit përgjegjës. Bashkësia hebraike tha se udhëheqësit fetarë e konsideruan këtë vendim zhgënjës; megjithatë, ata vazhduan të takoheshin rregullisht mes vete.

### **Seksioni III. Statusi i respektit shoqëror për lirinë fetare**

Pati raste të dhunës mbi baza fetare, të ndërhyrjes në pelegrinazhe fetare, të fjalimit urrejtës dhe vandalizmit. Pasi feja dhe përkatësia etnike shpesh janë të lidhura ngushtë, është vështirë të kategorizohen shumë incidente si incidente të bazuara në identitet fetar. Përfaqësues të KOS-it dhe organizata ndërkombëtare raportuan për rritje të sulmeve kundër serbëve në gjysmën e parë të vitit, disa duke komentuar që këto dhe sulme të tjera ndaj serbëve ortodoksë shpesh ishin të shtyra më tepër nga përkatësia etnike sesa feja.

Sipas raporteve të policisë, më 28 maj, shqiptarë të Kosovës bllokuan rrugën për të protestuar për vizitën e serbëve të zhvendosur në mbetjet e kishës në fshatin Petriç (komuna e Pejës). Protestuesit i gjuajtën pelegrinët me gurë dhe tre prej tyre pësuan lëndime të lehta. Megjithatë, 50 pelegrinë arritën të shkonin në vend.

Mediat dhe policia e Kosovës raportuan se më 30 maj, afër Istogut, një shqiptar sulmoi fqinjin e vet, një prift serb ortodoks dhe familjen e tij, gjersa ishin duke lëvizur me makinë. Policia ndaloi autorin e supozuar, të cilin prokurori e liroi më vonë për shkak të mungesës së provave. KOS-i u bëri thirrje autoriteteve lokale t'i mbajnë autorët e dhunës plotësisht përgjegjës sipas ligjit.

Më 21 tetor, mediat dhe policia raportuan se shqiptarët gjuajtën me gurë dy autobusë që bartnin pelegrinë serbë në afërsi të Istogut, derisa pelegrinët merrnin pjesë në shërbesat fetare. Shqiptarët e Kosovës vendosën një pengesë me një traktor dhe goma, por policia më pas shpërndau turmën dhe autobusët ia dolën të largoheshin nga vendi. Policia hetoi këtë rast dhe arrestoi tetë shqiptarë vendas të dyshuar për pjesëmarrje në incidente. Policia i liroi të dyshuarit pasi prokurorët zgjodhën të mos ngrinin akuza. Prokurorët nuk e shpjeguan arsyen për vendimin e tyre.

Më 6 janar, mediat dhe policia raportuan se një grup i shqiptarëve të Kosovës organizuan një protestë para kishës ortodokse serbe në Gjakovë, edhe pse serbët e zhvendosur kishin anuluar vizitën e tyre vjetore për shkak të shqetësimeve për siguri. Protestuesit bllokuan hyrjen në kishë për disa orë, ndërsa katër murgesha të moshuara mbetën të bllokuara brenda, duke penguar kremtimin e liturgjisë së krishtlindjeve ortodokse.

Mediat dhe policia raportuan se serbët e zhvendosur të Kosovës nga Gjakova anuluan vizitën e 28 gushtit për në kishën ortodokse serbe të qytetit, duke cituar mungesën e garancive për sigurinë e tyre. Banorët e Gjakovës organizuan një protestë para kishës duke kërkuar që qeveria serbe të kërkojë falje për krimet e kryera gjatë luftës në Kosovë. Policia arrestoi pesë protestues. Kryetari i Gjakovës, Ardian Gjini, u tha mediave se pelegrinët serbë duhet të kërkojnë leje për vizitë nga nënat shqiptare që i kanë humbur fëmijët gjatë luftës.

KOS-i raportoi për dy raste të ngacmimeve policore kundër klerikëve të saj në zonat e Kosovës me shumicë shqiptare. Sipas klerikëve, policët përdorën gjuhë joprofesionale dhe etnikisht të ngarkuar dhe bënë akuza të pabaza kundër tyre. Në një rast, viktimat paraqitën ankesë zyrtare në Inspektoratin Policor të Kosovës (IPK); megjithatë, IPK-ja vendosi se nuk mund të gjente element kriminal në këtë rast dhe e përcolli rastin tek Njësia e Standardeve Profesionale, që merret me shkelje disiplinore. As KOS-i, as Njësia e Standardeve Profesionale nuk raportuan për masa të mëtejme për këtë rast.

Politikanët nga Partia Lista Serbe (SL) kritikuan dhe herë pas herë kërcënuan peshkopin e KOS-it, Teodosije Sibaliq, dhe klerikë të tjerë të KOS-it në gazetatat, radiot, televizionin dhe kumtesat zyrtare për shtyp në gjuhën serbe pas kritikave të KOS-it ndaj qasjes së SL-së për procesin e normalizimit Kosovë-Serbi.

Gjatë gjithë vitit, KOS-i kritikoi mediat se i kontribuuan një klime të jotolerancës. BIK-u tha se sekularistët në media në përgjithësi i portretizonin myslimanët e devotshëm në një dritë negative, duke pohuar që portalet e lajmeve në internet nganjëherë e barazonin Islamin me terrorizmin.

Gjatë vitit, policia raportoi për 86 raste që synonin vendet fetare, ku përfshihej kryesisht dëmtimi i pronës dhe vjedhja, një rritje nga 44 raste në vitin 2017. Prej këtyre vendeve, 59 i përkisnin Bashkësisë Islame, 23 Kishës Ortodokse Serbe dhe katër Kishës Katolike.

Në mars, kroatët raportuan për përdhosjen e simboleve fetare në kishën katolike në fshatin Janjevë. Hetimi policor vazhdoi në fund të vitit.

Udhëheqësit fetarë vazhduan të merrnin pjesë në diskutime të shumta ndërfaqetare për të drejtat pronësore, prioritetet legjislativë dhe çështje të bashkësive lokale. OSBE-ja vazhdoi t'i koordinonte disa aktivitete mes grupeve fetare, përfshirë takimin me kryetarë të komunave, për t'i diskutuar çështjet si lejet për të ndërtuar objekte fetare.

#### **Seksioni IV. Politika dhe angazhimi i Qeverisë Amerikane**

Ambasadori dhe përfaqësues të tjerë të Ambasadës së SHBA-së u takuan shpesh me zyrtarë qeveritarë, përfshirë Presidentin, Kryeministrin, kryetarin e Kuvendit dhe anëtarë të Parlamentit, për ta nxitur miratimin e legjislacionit që do t'u lejonte institucioneve fetare të funksiononin pa pengesa. Zyrtarët e Ambasadës nxitën dialogun e shtuar mes anëtarëve shqiptarë të qeverisë dhe shoqërisë civile me anëtarë të KOS-it. Ambasada nxiti zyrtarët qeveritarë që ta zgjidhnin lejen kontestuese për ndërtimin e Kishës së Shën Nikollës në manastirin e Shën Arkangjelit në Prizren. Zyrtarët e Ambasadës nxitën qeverinë që ta respektonte ligjin për ZVM-të, posaçërisht në rastin e rrugës së planifikuar afër manastirit të Deçanit. Zyrtarët e Ambasadës publikisht dënuan mediat dhe sulmet politike kundër zyrtarëve të KOS-it. Ambasada mbështeti në të gjitha nivelet zbatimin e vendimit të vitit 2016 të Gjykatës Kushtetuese në favor të Manastirit të Deçanit, duke nxitur qeverinë dhe



gjyqësorin që t'i mbanin përgjegjës zyrtarët lokalë. Ambasada diskutoi çështjet pronësore të grupeve të tjera fetare me zyrtarë qeveritarë në shumë raste dhe i nxiti zyrtarët t'i respektonin ligjet e vendit. Zyrtarët e Ambasadës kërkuan nga Dogana e Kosovës në shumë raste që ta shtynin lëshimin e thirrjeve për gjykatë për komunitete fetare për keqpërdorim të supozuar të importeve pa doganë deri në sqarimin e Kodit Doganor dhe të ligjit që mbulonte përjashtimet doganore për organizatat fetare.

Zyrtarë të Ambasadës rregullisht diskutuan tolerancën fetare me udhëheqësit e të gjitha grupeve të mëdha fetare. Ata u takuan me imamët e BIK-ut dhe anëtarë të Fakultetit të Fesë Islame në Prishtinë për t'i diskutuar përpjekjet për ta mbështetur tolerancën dhe luftuar ekstremizmin e dhunshëm, dhe diskutuan projektligjet për liri fetare dhe trashëgimi kulturore. Zyrtarë të Ambasadës u takuan me udhëheqës fetarë në shumë raste për t'i diskutuar të drejtat e njeriut dhe shqetësimet e tyre ligjore dhe mbajtën tryeza të rrumbullakëta me myslimanët e respektuar fetarë për diskriminimin në punësim e arsim. Ambasada shpesh ka postuar porosi në mediat sociale në mbështetje të lirisë fetare

Në maj, zyrtarë vizitues të Departamentit të Shtetit u takuan me udhëheqës të BIK-ut dhe KOS-it për ta diskutuar rolin e bashkësive fetare në pajtimin ndëretnik. Zyrtarët gjithashtu u takuan me deputetë dhe zyrtarë të qeverisë për ta mbështetur miratimin e ligjit që do t'u mundësonte grupeve fetare të fitonin status ligjor dhe për ta inkurajuar qeverinë që t'i respektonte të drejtat e KOS-it dhe t'i angazhonte bashkësitë fetare më shumë në pajtimin ndëretnik. Në qershor, një delegacion i përbashkët nga qeveria dhe BIK-u udhëtoi për në SHBA në kuadër të një programi të Departamentit të Shtetit për ta hulumtuar rolin e bashkësive fetare në demokracitë shekulare. Në shtator, ambasada sponsorizoi vizitën e një eksperti ndërfetar nga SHBA-ja për t'u takuar me bashkësi fetare për ta diskutuar rolin e mediave gjatë raportimit për fenë.